

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së Kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit: [Emri i paditësit] dhe e [Emri i kundërtit] të cilën e përfaqëson [Emri i përfaqësuesit] të cilën e përfaqëson me autorizim [Emri i autorizuesit] kundër të paditurit: [Emri i paditurit] i nga [Emri i kundërtit], baza e kontestit: Pasurimi i Pa Bazë, në seancën e datës: 27.07.2015, komfor nenit 148 të LPK-së bien këtë:

A K T G J Y K I M
- në bazë të pohimit -

I.APROVOHET në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses [Emri i paditësit] i i [Emri i kundërtit] të cilën e përfaqëson me autorizim [Emri i autorizuesit] kundër të paditurit [Emri i paditurit] nga [Emri i kundërtit] si e Bazuar dhe

II.OBLIGOHET i padituri [Emri i paditurit] i qe ne emër të pasurimit të pa bazë, t'ia paguaj paditëses [Emri i paditësit], shumen prej **112 Euro**, në llogarinë rrjedhës numër [Numri i llogaritë]

III.OBLIGOHET i padituri qe ne emër te taksës për padi t'ia paguaj paditësit shumen prej **15 euro** të gjitha këto ne afat prej 7 ditor nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

IV. LIROHET i padituri nga shpenzimet gjyqësore sepse i njëjti është në asistencë sociale.

A r s y e t i m

Paditësja me datë: 31.12.2014 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurës.

Gjykata ka mbajtur seancën me datë: 27.07.2015 në te cilën prezantuan përfaqësuesja e te paditurës, dhe i padituri personalisht.

Në këtë seancë përfaqësuesja e paditëses deklaroi : " mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës së ushtruar pranë kësaj gjykate, kërkoj nga gjykata të mënjon aktgjykimin te aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të bazuar , ta detyroj të paditurin qe shumën e mjeteve prej 112 Euro se bashku me shpenzimet e gjykatës ti kthej ne llogarinë e paditëses, te gjitha këto ne afati prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Në këtë seancë i padituri deklarohet: "Është e vërtet se unë e kame tërhequr shumën e të hollave me mendimin se një gjë e tillë me takon pa ndonjë qëllim të keq. Unë me kohë rastin e vdekjes e kame njoftuar komunën dhe vakëfin (), nuk e di me tutje se çka ka ndodhur. Unë për shkak të gjendjes sime të dobët ekonomike si përfitues i ndihmës sociale deklaroj se nuk kame mundësi që ta kthej këtë shume pasi që kjo shume edhe ashtu tejkalon mundësitë e mija financiare".

Dhe pasi që Gjykata vlerësoi se pohimi i kërkesëpadisë nuk është në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK-së, dhe pa shqyrtim të mëtejshëm, në procesverbal në prezencën e palëve ndërgjyqëse, dhe duke pasur parasysh se ky pohim i kërkesëpadisë është në përputhshmëri të plotë me provat e poseduara në lëndë, gjykata mori aktgjykim në bazë të pohimit.

Andaj duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,
C.nr.879/2014 Më dt. 27.07.2015



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët e pa kështuqur ka të drejtë ankese në afat 15 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit nëpërmjet kësaj gjykate.

Atypedon palët

28.07.15

[Signature]